



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
FAKULTETI I EDUKIMIT DHE SHKENCAVE SHOQERORE
NJESIA BAZE E GJUHES LETERSISE DHE QYTETERIMIT GREK
GJIROKASTER

PROCEDURË PËR MIRATIMIN E NJË SYLLABUSI NË DEPARTAMENT

Përgjegjësi NJESISE BAZE
Prof. Asoc. **Panajot BARKA**



Syllabuset e lëndëve përbëjnë bërthamën e trekëndëshit që përcakton profilin akademik shkencor të Departamentit që janë: a- programi i studimit, b-plani mësimor dhe c- syllabuset.

Trajtimi i syllabuseve ka dy nivele:

Hartimi dhe përpunimi i një syllabusi të ri në kuadrin e një programi të ri studimi apo përmirësimi i një programi egzistues dhe përmirësimi i vet syllabusëve egzistues në kuadrin e një programi.

Syllabusi i ri kalon në katër faza.

Faza e parë: Përcaktimi

Në këtë kuptim syllabuset projektohen si ide bazë dhe titull që kur përcaktohet programi i studimit dhe vëçanërisht plani mësimor i tij, të cilët, përveç qëllimit bazë akademik-shkencor dhe praktik-profesional, marrin në konsideratë profilin e Departamentit dhe të stafit akademik të brendshëm, me kontratë pacaktuar.

Faza e dytë: Strukturimi.

Lidhet me punën individuale dhe në grupe. Çdo anëtar i stafit akademik merr përsipër, hartimin dhe strukturimin e një apo më shumë syllabusëve me cilësinë e titullarit të lëndës/ve përkatëse. Rekomandohet dhe punohet në grupe sipas profilit dhe karakterit të lëndëve apo të fushës. Sigurohet kohë e mjaftueshme për caktimin dhe hartimin e pjesëve përbërëse të një syllabusi si: të objektivave, të tematikës, saktësimi të raportëve midis teorisë dhe praktikës dhe mënyrës së zgjidhjes dhe zgjedhjes së tyre, të bibliografisë, mënyrës së shlyerjes etj.

Faza e tretë: Diskutimi, koordinimi.

Në një apo disa takime radhazi të të gjithë stafit akademik, duke respektuar pavarësinë akademike të çdo anëtari të këtij stafi, dëgjohen me vëmendje përmbajtja a çdo syllabusi në të gjitha elementët e tij. Diskutimi synon në përmirësimin e çdo syllabusi në të gjitha kimponontet e tij sidomos në përsa i përket tematikës dhe bibliografisë dhe koordinimi synon vlerësimin e syllabuseve për të patur një plan mësimor sa më të unifikuar dhe të efektshëm në aspektin përmbajtësor. Elimonohet përsëritjet e mundshme dhe bëhen plotësime përkatëse.


Faza e katërt: Korrigjimi - aprovimi

Kjo faze presupozon kryerjen e korrigjimeve dhe përmirësimin e mundshëm në bazë të fazes së tretë. Ato referohen në një mbledhje të fundit të stafit akademik i cili merr dhe vendimet përfundimtare aprovuese të syllabuseve, apo kthimin për korrigjime të reja.

E njëjta procedure ndiqet edhe kur vendoset për përmirësimin e planit mësimor të një programi të ekzistues studimi.

Përmirësimi i syllabusëve ekzistuese trajtohet në kuadrin e përmirësimit të përmbajtjes së saj me pike referimi pasqyrimin në përmbajtjen e saj të arritjeve të reja akademiko-shkencore dhe konsiderohet punë individuale dhe kolegjale akademiko-shkencore e Departamentit.

Përgjegjësi i Njësisë Bazë
Prof. asoc. Panajot Barka



PROGRAMI I LËNDËS

(METODAT E MËSIMDHËNIES SË GJUHËS GREKE
DHE TË LËNDËVE SHOQËRORE NË GJUHËN GREKE)

Titullari /pedagogu i lëndës: Dr. Kostando Ksera

Ngarkesa: 13 (ECTS), 167,5 orë mësimore në klasë (3/2) simestrin I dhe (3,5/2) simestrin II.

Gjithsej 97,5 leksione/ 60 seminare

Viti akademik/semestri kur zhvillohet: 2020-2021, Semestri I + II

Lloji i lëndës: E detyruar

Programi i studimit: " Master profesional në AMU në Gjuhe,Letersi & Qytërim Grek"

Adresa elektronike e titullarit/e pedagogut të lëndës: kostandoksera@yahoo.gr

Kodi i etikës: Integritet akademik i mbështetur në zbatimin me rigozitet të rregullores së programit të studimit dhe i rregullores së UGJ. Studenti është i detyruar të zbatojë Kodin e Etikës së UGJ.

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Studentet njihen me konceptet kryesore në lidhje me metodologjinë e mësimdhënies së lëndëve të gjuhës, letërsisë dhe lëndëve shoqërore. Ata përvetësojnë qëllimin dhe synimet bazë të zhvillimit të mësimin të këtyre lëndëve siç paraqiten në Kurrikulën bazë të Ministrisë së Arsimit.

Studentët njihen me nocionin dhe filozofinë e hartimit të Kurrikulës si dhe me përmbajtjen e programeve analitike për çdo lëndë më vete. Përmbajtja dhe struktura e teksteve shkollore për çdo lëndë. Metodot e ndryshme të mesimdhënies për çdo lëndë.

Përmbajtja dhe mënyrat e hartimit të planëve ditore të bazuara tek Kurrikula e re për arsimin parauniversitar me kompetenca dhe ndërveprim të fushave. Rëndësia e planit ditor për zhvillimin e procesit mësimor. Rëndësia e mateve dhe vlerësimi i nxënësit. Llojet e vlerësimit. Llojet e testeve etj. janë disa nga temat kryesore që do të trajtohen

OBJEKTIVAT E LËNDËS:

Objektivi kryesor i lëndës është pajisja e studenteve me njohuritë e nevojshme dhe metodat e ndryshme bashkëkohore rreth mësimdhënies së gjuhës, letërsisë dhe lëndëve shoqërore në ciklin fillor dhe 9- vjeçar, për tu bërë mësues të aftë dhe produktiv.

Studentet fitojnë njohuri në lidhje me:

Metodat e mësimdhënies dhe modelet didaktike kryesore.

Qëllimin dhe synimet e mësimin të gjuhës, të letërsisë dhe të lëndëve shoqërore.

Kurrikulën për arsimin parauniversitar me kompetenca.

Teorite e ndryshme rreth strategjise së mesimdhënies.

Pas përfundimit të lëndës studentët aftësohen:

Në hartimin e planit ditor për zhvillimin e një procesi didaktik për lëndët Gjuhë, Letërsi dhe lëndët shoqërore.

Në hartimin dhe përcaktimin e synimeve të mësimin.

Në mënyrat e ndryshme të vlerësimit të nxënësit.

Në mbajtjen e qetësisë dhe rregullit në klasë etj.

Studenti zbaton larmishmëri mënyrash dhe metodash për zhvillimin e procesit didaktik.

Harton teste të llojeve të ndryshme për vlerësimin e nxënësve.



KONCEPTET THEMELORE:

Metoda e mesimdhënies
Modeli didaktik.
Mesimdhënia dhe të nxënës
Qëllimi dhe synimet e mesimit
Planifikimi i procesit mesimor
Vlerësimi i nxënësit
Plani ditor
Plani mesimor vjetor
Kurrikula me kopetencia

TEMAT KRYESORE

Java I – Sistemi arsimor - Metodologjia e mesimdhënies

Objekti i Metodologjisë së mesimdhënies. Mesimdhënia dhe të nxënës. Mesimdhënia e gjuhës, letërsisë dhe lëndëve shoqërore. Parimet bazë për mesimdhënien e tyre. Zhvillimi i nxënësit. Stimulimi i nxënësit. (Liter.: Τριλιανός, 2000: 91-106)

Java II- Struktura e sistemit Arsimor. Përgatitja e arsimtarëve. Aftësitë dhe njohuritë që duhet të zotërojnë arsimtarët në mënyrë që të jenë produktiv. Njohuri në lidhje me fushën e lëndës por dhe njohuri Pedagogjiko - didaktike si dhe menaxhuese. (Liter.: Τριλιανός, 2000: 245-258)

Java III - Metoda e pershtatshme për mesimdhënie

Metodat e mesimdhënies. Modelet didaktike. Mesimdhënia direkte dhe indirekte. Mesimdhënia me në qendër mësuesin. Mesimdhënia me në qendër nxënës dhe me në qendër objektin didaktik. Mesimdhënia e alternuar. Mesimdhënia si profesion, si art dhe si teknikë. (Liter.: Τριλιανός, 2000: 161-181).

Java IV : Zgjedhja e metodës së pershtatshme për çdo orë mësimi.

Kriteret bazë për zgjedhjen e metodës. Njohja e klasës. Njohja e subjektit. Njohja e parimeve të mesimdhënies. Metoda dhe stimulimi i të nxënës. (Liter.: Τριλιανός, 2000: 161-181)

Java V: Si mësojnë nxënës. 12 parimet bazë rreth mesimdhënies dhe të nxënës në bazë të kartës së unescos.

http://www.ibe.unesco.org/sites/default/files/resources/edu-practices_07_gre.pdf

Java VI: Kurrikula e re me kompetenca dhe ndërveprim të fushave

Njohja me Kurrikulën e re me kompetenca dhe ndërveprim të fushave dhe me programet analitike për çdo shkallë dhe klasë në veçanti. Kompetencat e fushës dhe kompetencat e përgjithshme. Kompetencat (të folurit, të dëgjimit, të leximit, të shkruarit, njohuri për gjuhën) dhe zhvillimi i tyre tek nxënësi për çdo orë mësimi. Liter: <http://www.izha.edu.al/programe-lendore/programet-e-arsimit-baze-kurrikula-e-re/>

Java VII: Zbërthimi i Kurrikulës dhe programeve analitike për çdo klasë.

Njohja e studentëve me detajet e Kurrikulës dhe të PA për çdo klasë. Zhvillimi i katër kompetencave gjatë çdo procesi didaktik. Liter: <http://www.izha.edu.al/programe-lendore/programet-e-arsimit-baze-kurrikula-e-re/>



Java VIII: Qëllimi dhe synimet e mësimdhënies së gjuhës, letërsisë dhe lëndëve shoqërore
Qëllimi dhe synimet e mësimin të gjuhës dhe letërsisë në shkollat fillore. Qëllimet e paraqitura në Kurrikulën e re. Kriteret bazë për hartimin e qëllimeve për çdo lëndë. Zbërthimi i kurrikulës dhe hartimi i planit vjetor për çdo lëndë. Liter: <http://www.izha.edu.al/programet-e-arsimit-baze-kurrikula-e-re/>; <http://www.pi-schools.gr/programs/depps>

Java IX : Qëllimi i mësimdhënies së lëndëve shoqërore.

Përvetësimi i qëllimeve të përcaktuara në kurrikulën e re. Zbërthimi i kurrikulës dhe hartimi i planit vjetor për çdo lëndë. Njohja e qëllimeve domosdoshmëri për arritjen e rezultateve të larta në mësimdhënie. Liter: <http://www.izha.edu.al/programet-e-arsimit-baze-kurrikula-e-re/>

Java X : Synimet e orës së mësimin

Rëndësia e vendosjes së synimeve në një proces didaktik. Pa synime të qarta dhe të matshme nuk ka rezultate të matshme. Kriteret për vendosjen e synimeve të orës mësimore. (Liter.: Τριλιανός, 2000: 127-140) <http://www.pi-schools.gr/programs/depps>

Java XI : Zbatimi i kriterëve bazë për vendosjen e synimeve të orës mësimore dhe të kapitullit.
Marrëdhënia e qëllimit të mësimin me synimet. Formulimi i synimeve të mësimin. Aftësimi i studentëve në përcaktimin e synimeve të orës mësimore. Kriteret për vendosjen e synimeve të orës mësimore. Synimet përcaktohen si përgjigje e pyetjes {Çfarë duhet të dinë nxënësit në fund të një procesi mësimor?} (Liter.: Τριλιανός, 2000: 140-156) <http://www.pi-schools.gr/programs/depps>

Java XII: Tekstet shkollore – dhe strategjia e mësimdhënies

Njohja me tekstet shkollore që përdoren në shkollat e Minoritetit Etnik Grek për çdo klasë në veçanti. Procesi i hartimit të teksteve shkollore. Tekstet dhe përshtatja e tyre me programin mësimor. Hartimi i teksteve shkollore të bazuara në Kurrikulën e re dhe në përputhje me programet analitike. Parashikimi i veprimtarive në tekstet për zhvillimin i kompetencave kyçe. Familjarizimi me tekstet shkollore të Gjuhës amtare greke të ciklit fillor për shkollat e MEG.

Java XIII : Njohja dhe vlerësimi i teksteve mësimore për çdo klasë.

Paraqitja e temës, ushtrimet për përpunim dijes, ushtrime për vlerësimin e dijevë. Përshtatshmëria e veprimtarive. Përshtatja e teksteve me programet përkatëse. Planifikimi dhe programimi i lëndës në përshtatje me tekstin dhe Programin Analitik.

Java XIV: Programimi i procesit didaktik

Rëndësia e programimit të procesit didaktik. Parametrat bazë që duhet të kemi parasysh gjatë programimit të procesit didaktik. Niveli i klasës, lloji i lëndës, dijet e mëparshme. Programimi i mësimdhënies garanci për sukses. (Liter.: Τριλιανός, 2000: 195-213)

Java XV: Parametrat bazë që duhet të kemi parasysh gjatë programimit të procesit didaktik.
Strategji të ndryshme për zhvillimin e një procesi didaktik. Programimi i një procesi didaktik duke ndjekur fazat e dhura. (Liter.: Τριλιανός, 2000: 213-228)

Java XVI : Mësimdhënia në klasën e parë

Mësimdhënia e leximit dhe shkrimit në klasën e parë. Nocioni i leximit dhe rendesia e tij në realizimin e programit mësimor. Metoda analitike. Rëndësia e aftësimit në lexim. Fazat e metodës analitike për mësimin e leximit në klasën e parë. Anët pozitive dhe negative të saj. Programimi i një procesi didaktik sipas metodës analitike. (Liter.: Χαλαμπόπουλου: 23-32)



Java XVII: Metoda analitiko –sintetike dhe metoda gjithpërfshirëse.

Alternimi i metodave të reja dhe të vjetra. Fazat e programimit të një procesi didaktik në klasën e parë. Vëzhgimi dhe komentimi i një procesi didaktik në klasën e parë. Programimi i një procesi didaktik sipas metodës analitiko – sintetike. (Liter.: Χαραλαμπίδου: 23-32)

Java XVIII : Mësimdhënia e shkrimit në klasën e parë.

Mësimdhënia e leximit dhe shkrimit nëpërmjet teksteve letrare. Kultivimi i gjuhës së folur dhe të shkruar. Katër kompetencat. (Liter.: Χαραλαμπίδου: 23-32)

Java XIX : Mësimdhënia e teksteve letrare

Kultivimi i katër kompetencave në klasat e shkallës së parë (II,III). Qasja e teksteve letrare. Prezantimi i një procesi didaktik. Programimi i një ore mësimi në klasën e dytë dhe të tretë duke kultivuar katër kompetencat. (dëgjojmë, flasim, lexojmë, shkruajmë) dhe mësojmë sistemin e gjuhës. (Liter.: Χαραλαμπίδου: 39-42)

Java XX: Mësimdhënia e letërsisë (prozë)

Mësimdhënia e teksteve letrare (prozë). Qëllimi i mësimi të letërsisë në shkollë. Hartimi i planit ditor për mësimdhënien e një proze. Parimet bazë për hartimin e procesit didaktik. Etapat e analizës stilistike të pjesëve letrare. (Liter.: Χαραλαμπίδου: 44-46)

Java XXI: Mësimdhënia e gjuhës dhe teksteve letrare.

Kultivimi i katër kompetencat në klasat IV, V. Prezantimi i një procesi didaktik. Vëzhgimi rreth realizimit të një ore mësimi në klasën e katërt dhe të pestë duke kultivuar katër kompetencat. (dëgjojmë, flasim, lexojmë, shkruajmë) dhe mësojmë sistemin e gjuhës. (Liter.: Χαραλαμπίδου: 13-19)

Java XXII: Mësimdhënia e leksikut

Rëndësia e leksikut në programin mësimor. Mësimdhënia e leksikut. Metoda të ndryshme rreth mësimdhënies së leksikut. Leksiku si pjesë e zhvillimit gjuhësor të nxënësit. Strategji të ndryshme rreth mësimdhënies së leksikut. Prezantimi i një ore mësimi në lidhje me mësimdhënien leksikun.

Java XXIII: Mësimdhënia e gjuhës së folur.

Nocioni i gjuhës së folur dhe i mësimdhënies së saj. Nevoja e kultivimit të gjuhës së folur. Mësimdhënia e përrallave. Mësimdhënia e leksikut. Metodologjia e mësimdhënies së leksikut. Mësimdhënia e komunikatave të lira. (Liter. Χαραλαμπίδου: 87- 97)

Java XXIV: Mësimdhënia e gramatikës

Mësimdhënia e fenomeneve gramatikore. Nocioni i gramatikës. Gramatika funksionale. Rëndësia e gramatikës. Gramatika si pjesë e mësimi funksional të gjuhës. Vendi që zë gramatika në mësimin e gjuhës. (Liter.: Χαραλαμπίδου: 65-69)

Java XXV : Mësimdhënia e letërsisë (poezi)

Poezia dhe vendi që ajo zë në programin mësimor. Qëllimi i mësimi të poezisë në shkollë. Mësimdhënia e teksteve letrare (poezi). Vecoritë e mësimdhënies së poezisë. (Liter.: Χαραλαμπίδου: 56-60)

Java XXVI : Mësimdhënia e hartimit

Kultivimi i gjuhës së shkruar. Mësimdhënia e hartimit. Kompetenca e të shkruarit për qëllime personale. Rregullat bazë për hartimin e teksteve të llojeve të ndryshme. Programimi i një ore mësimi për mësimdhënien e hartimit e bazuar në rregullat kryesore që duhen ndjekur. (Liter.: Χαραλαμπίδου: 75-83)



Java XXVII : Mësimdhënia e lëndëve shoqërore

Mësimdhënia e lëndëve shoqërore. Vendi i tyre në programin mësimor. Zbërthimi i programit vjetor në përshtatje me tekstet shkollore. Vecoritë e mësimdhënies së lëndëve shoqërore. Njohja me tekstet e lëndëve shoqërore (Edukatë për shoqërinë, Histori) Liter: <http://www.izha.edu.al/programe-lendore/programet-e-arsimit-baze-kurrikula-e-re/>

Java XXVIII : Mësimdhënia e Historisë.

Strategji të ndryshme për mesimdhënien e Historisë. Hartimi i nje procesi didaktik. Parimet bazë që duhen marrë parasysh. Programimi i një procesi didaktik në lëndët shoqërore. Kontrolli i dijeve të mëparshme, lidhja e temës së re me përjetimet e nxënësve, prezantimi i dijeve të reja, përmledhja e lëndës, vlerësimi i të nxënësve. (Liter.: Χαραλαμπίδου: 155-162)

Java XXIX: Mësimdhënia e Edukatës për Shoqërinë.

Strategji të ndryshme mesimdhënieje. Hartimi i nje procesi didaktik. Parimet bazë që duhen marrë parasysh. Veçitë e mësimdhënies së Edukatës. Vëzhgimi dhe diskutimi i një procesi didaktik në lëndët shoqërore. Kontrolli i dijeve të mëparshme, lidhja e temës së re me përjetimet e nxënësve, prezantimi i dijeve të reja, përmledhja e lëndës, vlerësimi i të nxënësve. (Liter.: Χαραλαμπίδου: 169-174)

Java: XXX : Vlerësimi.

Rëndësia e vlerësimit për arritjet e të nxënësve. Mënyrat e vlerësimit. Hartimi i testeve të llojeve të ndryshme. Vetëvlerësimi. Njohja me mënyrat e ndryshme të vlerësimit. Hartimi i testeve të llojeve të ndryshme. (Liter.: Τριλιανός, 2000: 105-124)

FORMA E KONTROLLIT TË DIJEVE:

FREKUENTIMI: Kontroll i vazhduar, detyra kontrolli dhe provim me shkrim. Studenti ka detyrime të frekuentojë mësimin. Leksionet frekuentohen në mënyrë fakultative, por rekomandohet që studenti të marrë pjesë rregullisht në to. Frekuentimi i ushtrimeve e seminareve është i detyrueshëm në masën 75%. Studenti që nuk merr pjesë në 25% të seminareve cilësohet i paklasifikuar dhe nuk lejohet të hyjë në provim

KONTROLLI I VAZHDUESHËM:

Rezultatet e kontrollit të vazhdueshëm vjetor	20%
Rezultatet në realizimin e detyrës me shkrim apo projektit kolektiv të lëndës	
Rezultati i provimit përfundimtar	80 %

Mënyra e vlerësimit: Kontroll i vazhduar - provim me shkrim. Vlerësimi i vazhduar do të jete shumatore e vlerësimit të pedagogut mbi kryerjen e detyrave si me poshte:, Studenti rezulton kalues me minimalisht 45% të vlerësimit total apo 45 pike.

- rezultatet e testeve 10 %
- aktivizimin në seancat e seminareve 10 %

Studenti rezulton kalues me minimalisht 45% të vlerësimit total apo 45 pike.

PROVA FINALE: Provim me shkrim e fund të semestrit



LITERATURA

Literatura bazë e detyrueshme:

- IZHA 2016 «Kurikula bërthamë»
- Βουγιούκας, Α.: «Το γλωσσικό μάθημα στην πρώτη βαθμίδα της νεοελληνικής εκπαίδευσης». Ιδρυμα Μανόλη Τριανταφυλλίδη, 2010
- Παιδαγωγικό Ινστιτούτο «Διαθεματικό ενιαίο πλαίσιο προγραμμάτων σπουδών και αναλυτικά προγράμματα σπουδών Δημοτικού – Γυμνασίου»
- Τριλιανός, Θ. (2003) «Μεθοδολογία της Σύγχρονης Διδασκαλίας», Αθήνα
- Χαραλαμπίδου, Βασίλη: Οργάνωση της διδασκαλίας και της μάθησης, ειδικά και κατά μάθημα, Gutenberg.

Literatura e rekomanduar:

- Κωνσταντίνου Χαραλαμπίδου, Το καλό σχολείο, ο ικανός εκπαιδευτικός και η κατάλληλη αγωγή, Gutenberg, 2017
- Κωνσταντίνου Χαραλαμπίδου, Το καλό σχολείο, ο ικανός εκπαιδευτικός και η κατάλληλη αγωγή, Gutenberg Gutenberg, 2015
- Νικολάου, Γ. (2011) Διαπολιτισμική Διδακτική, εκδόσεις Πεδίο.
- Παπανδρέου, Α. «Μεθοδολογία της διδασκαλίας»
- Φλουρής, Γ. (1995). «Αντιστοιχία Εκπαιδευτικών Σκοπών, Αναλυτικού Προγράμματος και Εκπαιδευτικών Μέσων: Όψεις της Εκπαιδευτικής Αντιφατικότητας» Αθήνα: Σείριος
- Φλουρής, Γ. (2000). Αναλυτικά Προγράμματα για μια Νέα Εποχή στην Εκπαίδευση, εκδ. «Γρηγόρη», Αθήνα, 2000.
- Χαραλαμπίδου, Α. και Κωστούλη, Τρ. (2000) Διδασκαλία λειτουργικής χρήσης της γλώσσας. Γλωσσικές δραστηριότητες για το Δημοτικό Σχολείο. Θεσσαλονίκη: Κώδικας

<http://www.izha.edu.al/programe-lendore/programet-e-arsimit-baze-kurrikula-e-re/>

<http://www.pi-schools.gr/programs/depps>

VËREJTJE PËRFUNDIMTARE NGA PEDAGOGU I LËNËS :

Studentet janë të detyruar të veprojnë në përputhje me dhe të respektojnë në mënyrë rigorozë tërësinë e rregullave, pritshmërive dhe sanksioneve përkatëse të parashikuara në rregulloren e UGJ-se për t'u sjellë me integritet akademik mbështetur në ndershmërinë.

Studentet janë të detyruar :

- Të mos kopjojnë apo japin kopje në provim
 - Të mos kopjojnë dhe paraqesin punën e dikujt tjetër
 - Të mos fabrikojnë apo manipulojnë të dhënat
 - Të respektojnë integritetin dhe dinjtetin njëzëor & profesional të personelit akademik dhe atij ndihmes
 - Të respektojnë integritetin dhe dinjtetin njëzëor & profesional të studenteve të tjerë
- Në rast se shkellesh të këtyre rregullave studentet penalizohen siç parashikon rregullorja e UGJ-se dhe rregullorja e programit të studimit.

MIRATOHET

PËRGJEGJËSI DEPARTAMENTIT

Prof. Asoc. Dr. Panajot Barka

